



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK FIER  
KRYESIA

Nr.

Fier në 19.11. 2024

VENDIM NR. 19 DATË 19.11.2024

**PËR MIRATIMIN E RENDIT PARAPRAK TË DITËS PËR MBLEDHJEN E DATËS**

Kryesia e Këshillit Bashkiak Fier në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 27 datë 15.04.2020 “ Për miratimin e rregullores së Këshillit Bashkiak, rregullores për Konsultimet Publike dhe Kodin e Sjelles për funksionimin e Këshillit”, Kreu 2, neni 22 “Kryesia e Këshillit “ neni 1, 3, 4

**VENDOSI:**

- 1-Miratimin e Rendit paraparak të Ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të zhvillohet në datën 26.11.2024 . Bashkëlidhur këtij vendimi gjenden pikat e Rendit paraparak të Ditës.
- 2-Ngarkohet Sekretari i Këshillit Bashkiak për publikimin e njoftimit të Rendit të Ditës, si dhe njoftimin e Këshilltarëve. Kryetarit të Bashkisë dhe çdo personi tjetër të interesuar për pjesëmarrje në mbledhjen e Këshillit Bashkiak.
- 3-Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYESIA E KËSHILLIT**

1-Antoneta Çunaj

2-Endri Jaupaj

3-Fatbardha Merkaç

4-Lvis Sema

5-Kreshnik Dapi

6-Arben Çuko



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 12079 Prot.

Fier, më 19.11.2024

**Lënda:** Njoftim mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit të Bashkisë

**Drejtuar:** ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË BASHKISË FIER

**Për dijeni:** KRYETARIT TË BASHKISË FIER  
PREFEKTIT TË QARKUT FIER

Në mbështetje të nenit 53 pika 4, nenit 56 pika 2, shkronja "a", të Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, ju njoftojmë thirrjen e mbledhjes së radhës së Këshillit të Bashkisë Fier në sallën e këshillit ditën e **Martë, datë 26.11.2024 në orën 12:00** me këtë rend dite:

1. Miratimi i Rendit të Ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit të Bashkisë, datë **30.10.2024**;
3. Projekt – vendim: "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i 6% për muajin Tetor 2024";
4. Projekt-vendim "Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin social të strehimit "Subvencionimi i qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij" për vitin 2025;
5. Projekt-vendim "Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë dhe miratimin e vlerës mesatare të qirasë në tregun e lirë, për efekt të llogaritjes së masës së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij, për vitin 2025";
6. Projekt-vendim "Për mbulimin e shpenzimeve të transportit të nxënësve të arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2024-2025, me largësi mbi 2 km";
7. Projekt-vendim " Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore të vitit 2025";
8. Projekt – vendim: "Për një ndryshim në projektin "Ndërtim i KUZ-së, lagja "Afrim" Bashkia Fier, si dhe autorizimin e ekzekutivit të Bashkisë për vijimin e procedurave të shpronësimit për interes publik në kuadër të realizimit të këtij projekti ;
9. Projekt-vendim "Për miratimin e kërkesës së Shoqërisë "Aga -Solar" sh.p.k për dhënien e së drejtës së kalimit "Për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e linjës nëntokësore së transferimit të energjisë elektrike" në pronat e Bashkisë Fier;

10. Projekt-vendim "Për miratimin e kërkesës së Shoqërisë "Albania Poëer Core" sh.p.k për dhënien e së drejtës së kalimit "Për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e linjës nëntokësore të transferimit të energjisë elektrike" në pronat e Bashkisë Fier;
11. Projekt-vendim "Për miratimin e dhënies pa kundërshpërblim të pasurisë nr.3/257-B1, Zk Nr.8534, me sipërfaqe 610 m<sup>2</sup> e llojit "Bodrum" ndodhur në Lagjen "Apollonia", pronë e Bashkisë Fier Shoqatës "Bilardo Apollonia Fier" me qëllim përdorimin dhe shfrytëzimin vetëm për veprimtari dhe aktivitete sportive si dhe qëndër ditore për moshën e tretë" ;
12. Projekt-vendim "Për miratimin e tabelës me të dhënat e listës emërore të pronave dhe pronarëve që do të shpronësohen për objektin (Për objekte e banimit, shërbimit dhe truallit) që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksioni i Segmentit rrugor "Shën Gjergji -Naun Kaçaku (ish Ura me shkallë -Stacioni i Patosit) vlerësim paraprak, më qëllim mbulimin e vlerës paraprake të shpronësimit për interes publik nga Buxheti i Bashkisë Fier për përfundimin e miratimit të procesit të shpronësimit për interes publik.
13. Diskutime dhe komente

**Kryetar i Këshillit**

**Antoneta Çunaj**

